



**EKR EKSPERTE KONTABËL E REGJISTRUAR**  
**FATMIRA KASTRATI (SYKJA)**

*NR LICENCE 14, datë 11/01/2000*



## **RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR**

Për auditimin ligjor të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara

Partia « Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve »

VITI 2014



**RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR**

**KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**TIRANË**

Të nderuar zotërinj!

Në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Regjistruar, bazuar në vendimin numër 969, dt.10.08.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe të kontratës të shërbimit lidhur me të me numër protokollit të sajën 7707, datë 29.09.2015, kam audituar pasqyrat që lidhen me financimin e fondeve të përfuara dhe të shpenzuara për vitin 2014 nga partia "Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve".

Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtuesve të partisë "Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve". Detyra e subjektit zgjedhor është të përgatisë pasqyrat mbi bazën e arkëtimeve dhe pagesave.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer. Auditimi u krye në zbatim të kërkesave të Standarteve Ndërkombetare të Auditimit, në referencë të veçantë me SNA-në 800: "Auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrove për qëllime specifike".

Këto standarte kërkojnë që unë të planifikoj dhe të kryej auditimin për të zotëruar siguri të arsyeshme se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: librin e llogarive të subjektit, regjistrin e posaçëm të miratuar si model me vendim nr.266 të KQZ-së, dt.01.06.2009 si dhe pasqyrën e arketim pagesave. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Unë çmoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim të auditimit.

Partia "Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve", për vitin 2014 nuk ka përfutur fonde publike. Kjo edhe sipas deklaratës bashkëngjitur këtij raport.

**OPINIONI**

Partia "Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve", sipas dokumenteve të sipërcituara, nuk ka përfutur fonde për vitin 2014.

Bashkëlidhur dokumentet përkatëse.

Tiranë, më 25 nëntor 2015

**EKSPERTE KONTABËL E REGJISTRUAR**  
**FATMIRA KASTRATI (SYKJA)**



